

20140180521

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR VEPRIMTARI FILMIKE**

Neni 1

Në Ligjin për veprimtari filmike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 82/13), në nenin 12 paragrafi (1) alineja 1 përqindja "1,1" zëvendësohet me përqindjen "0,9".

Në alinenë 2 përqindja "1,1" zëvendësohet me përqindjen "0,9".

Në alinenë 3 përqindja "1,1" zëvendësohet me përqindjen "0,9".

Alineja 4 ndryshohet si vijon:

"- 1% nga të hyrat e operatorëve të rrjeteve publike elektronike të komunikimit që rriemetojnë servise programore të radiodifuzerëve,".

Alineja 5 ndryshohet si vijon:

"-1% nga të hyrat e personave juridikë që sigurojnë qasje në internet,".

Në alinenë 7 numri "3" zëvendësohet me numrin "2".

Alineja 8 ndryshohet si vijon:

"- 3% nga dallimi ndërmjet shumës së paguar nga të gjithë kompjuterët në të gjitha vendpagesat e organizuesit të lojërave të fatit në bastore dhe shuma e paguar në të gjithë kompjuterët në të gjitha vendpagesat e organizuesit të lojërave të fatit në bastore dhe".

Pas alinesë 8 shtohet aline e re 9, si vijon:

"-3% nga dallimi ndërmjet shumës së paguar nga të gjithë automatët në të gjitha lokalet afariste të organizuesit të lojërave të fatit në automat klube dhe kazino dhe shuma e paguar në të gjithë automatet në të gjitha lokalet afariste të organizuesit të lojërave të fatit në automat klube dhe kazino".

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Kompensimet nga paragrafi (1) alineja prej 1 deri në 7 të këtij neni, personat juridikë i llogaritin nga të hyrat vjetore të përgjithshme të realizuara në vitin paraprak nga veprimtaria që paraqet bazë për përcaktimin e kompensimeve nga paragrafi (1) alinetë prej 1 deri në 7 të këtij neni".

Neni 2

Titulli i nenit 13 dhe neni 13 ndryshohen si vijojnë:

**"Procedura për pagesë të kompensimeve në Agjenci**

Neni 13

(1) Personat juridikë që kanë detyrim për pagesë të kompensimeve nga neni 12 paragrafi (1) alinetë prej 1 deri në 7 të këtij ligji janë të obliguar që në Agjenci të dorëzojnë të dhëna për të hyrat e realizuara për kryerjen e veprimtarive nga neni 12 paragrafi (1) alinetë prej 1 deri në 7 të këtij ligji, deri më 15 mars në vitin rrjedhës për vitin paraprak.

(2) Agjencia pas të dhënave të mara nga personi juridik për të hyra të realizuara nga kryerja e veprimtarive nga neni 12 paragrafi (1) alinetë prej 1 deri në 7 të këtij ligji, një herë në vit në mars në vitin rrjedhës për vitin paraprak u lëshon aktvendim për përcaktimin e lartësisë së kompensimeve.

(3) Personat juridikë nga neni 12 paragrafi (1) alinetë prej 1 deri në 7 të këtij ligji, në afat prej 30 ditësh nga marrja e aktvendimit nga paragrafi (2) të këtij neni, i paguajnë kompensimet në llogari të Agjencisë dhe në afat prej pesë ditësh dorëzojnë dëshmi në Agjenci për pagesën e kryer.

(4) Personat juridikë nga neni 12 paragrafi (1) alinetë 8 dhe 9 të këtij ligji, kompensimet në bazë mujore ia paguajnë Agjencisë deri më 15 të muajit rrjedhës për muajin paraprak.

(5) Personat juridikë nga paragrafi (4) të këtij neni janë të obliguar ta dorëzojnë dëshminë për pagesë të kryer të kompensimeve në Agjenci më së voni deri më 15 të muajit rrjedhës për muajin paraprak.

(6) Nëse personat juridikë kompensimet nga neni 12 paragrafi (1) të këtij ligji nuk i paguajnë në llogari të Agjencisë në afatin nga paragrafi (3), përkatësisht në afatin nga paragrafi (4) të këtij neni, Agjencia kundër tyre do të parashtojë padi në gjykatën kompetente."

#### Neni 3

Në nenin 56 paragrafi (1) fjalët: "në afat prej 30 ditësh nga marrja e aktvendimit, nuk i paguan kompensimet në llogari të Agjencisë (neni 13 paragrafi (2))" zëvendësohen me fjalët: "kompensimet nga neni 12 paragrafi (1) të këtij ligji nuk i paguan në llogari të Agjencisë në afatin nga neni 13 paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji (neni 13 paragrafët (3) dhe (4))".

#### Neni 4

Në nenin 63 paragrafi (2) pas numrit "12" shtohen fjalët: "paragrafi (1) alinetë prej 1 deri në 7".

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Kompensimet nga neni 12 paragrafi (1) alinetë 8 dhe 9 të këtij ligji për vitin 2014 do të paguhën në llogari të Agjencisë, në afatin nga neni 13 paragrafi (4) të këtij ligji."

#### Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".